

Prof. Dr. Arta Mandro - Balili: Me Vendimin Nr.78/2022 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, është zgjedhur anëtare e Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga trupa e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe Shkollës së Magjistraturës.

Është diplomuar për drejtësi në Universitetin e Tiranës dhe ka titullin akademik "Profesor" prej vitin 2009. Ka një karrierë të pasur në edukimin ligjor, fillimisht si pedagog, titullare lënde "E Drejta Romake" në Universitetin e Tiranës dhe më pas në Shkollën e Magjistraturës, si lektore në programin e trajnimit fillestar dhe njëherazi si eksperte e trajnuese në programin e formimit vazhdues me fokus gjyqtarët e prokurorët në detyrë. Është eksperte në fushën e të Drejtës Familjare dhe të Drejtave të Fëmijëve, Ndërmjetësimit, të barazisë gjinore dhe mosdiskriminim si dhe në fushën e të Drejtës Ndërkombëtare Private.

Prof. Mandro ka qenë një nga hartueset e Kodit të Familjes, Kodit dhe Komentarit të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, Ligjit për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare dhe Komentarit të tij, Ligjit për Barazinë Gjinore në Shoqëri, Ligjit për Strehimin Social si dhe e disa dokumenteve strategjike mbi politikën e procedurave kundër dhunës e ngacmimit në punë. Ajo është autore dhe bashkëautore e disa teksteve mësimore universitare dhe pasuniversitare dhe ka marrë pjesë në disa studime në nivel kombëtar e ndërkombëtar.

Prof. Mandro ka luajtur një rol aktiv në përgatitjen e raporteve të shtetit shqiptar dhe raporteve hije/alternative në kuadrin e raportimeve për organizatat ndërkombëtare. Ajo ka një sërë specializimesh dhe trajnimesh jashtë vendit dhe ka referuar në shumë aktivitetesh ndërkombëtare.